

Formular për SYLLABUS të Lëndës – Akuakultura e ujerave te embla

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN
Titulli i lëndës:	Akuakultura e ujerave te embla
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti I II-te,
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	E premte 12-13.30 Salla C
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Linda Grapci-Kotori, prof.asoc
Detajet kontaktuese:	linda.grapci@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Në mbarë botën, akuakultura është një nga format më të lashta të kultivimit te shtazeve. Aktualisht, kultura e biotës ujore për konsumin e drejtpërdrejtë, zgjerimin e stoqeve apo qëllime të tjera është sektori më i shpejtë dhe më i larmishëm i prodhimit blegtoral. Qëllimi i këtij kursi është të zhvillojë një kuptim të sistemeve të kulturës së zakonshme, të njohë bazat e peshkut dhe të vlerësojë rolin e akuakulturës në menaxhimin e burimeve natyrore, furnizimin me ushqimin njerëzor dhe ekonominë globale.
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi kryesor i kursit është si më poshtë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të njihen me dizajnimin dhe funksionimin e objekteve ku kultivohet peshku (pellgje, sisteme rrjedhëse, sisteme ricikluese të akuakulturës, operacione të integruara të akuakulturës etj) 2. Të njihen me aspektet praktike të akuakulturës (ushqimet dhe te ushqyerjet, teknikat e stoqeve, transportit dhe korrjes, marketingun dhe ekonominë, parandalimin, diagnozën dhe trajtimin e sëmundjeve, etj) 3. Të vlerësohet gjendja e akuakulturës në Kosovë dhe jashtë saj
Rezultatet e te nxenit	<p>Deri në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Te përshkruajnë llojet e ndryshme të sistemeve të akuakulturës - Te kuptojnë faktorët e ndikimit ne sistemet e akuakultures dhe mënyrën se si ato mund të manipulohen - Te përshkruajnë mekanizmat e pastrimit të ujit - Te përshkruani metodologjitë themelore ne fushën e akuakultures, problemet e përbashkëta dhe te bejne zgjidhjen e llojeve të rëndësishme për tregun

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	5	10
Ushtrime në teren	4	3	12
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	4	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	2	3	6
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në laborator dhe në teren , konsultime , detyra shtëpie, kollokuiume, provime		
Metodat e vlerësimit:	Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim: Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%		
Literature:			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. . Tidwell, J.H. Aquaculture Production Systems. Wiley-Blackwell. 2. Lucas J.S. and Southgate, P.C. Aquaculture, farming aquatic animals and plants. Wiley-Blackwell 3. . Parker R. Aquaculture Science. Delmar Cengage Learning/ 		
Literatura shtese	...		

	<p>1. Aquaculture Principles and Practices, 2nd Edition, T.V.R. Pillay and M.N. Kutty, 2005. Blackwell Publishing.</p> <p>...</p> <p>2. Fish Hatchery Management, 2nd Edition, G.A. Wedemeyer. 2001. American Fisheries Society.</p>
--	--

Plani i dizajnuar i mësimit: per ligjerata	
WeekJava	
Java e parë:	Hyrje ne Akuakulture
Java e dytë:	Burimet ujore/ sistemet e qarkullimit te ujit
Java e tretë:	Bazenet per kultivimin e peshqve
Java e katërt:	Hapesirat e posaqme per sshumezimin e peshkut
Java e pestë:	Aspekti kimik I kualitetit te ujit
Java e gjashtë:	Aspekti fizik I kualitetit te ujit
Java e shtatë:	Ushqimi natyral dhe ai I pregaditur/ Vleresimi intermedier
Java e tetë:	Kerkesat per vitamina, minerale, dhe proteina
Java e nëntë:	Strategjia e ushqimit/ kerkesat per lipide dhe karbohidrate
Java e dhjetë:	Diagnosa dhe parandalimi I semundjeve ne akuakulture
Java e njëmbëdhjetë:	Teknikat e grumbullimit te peshkut
Java e dymbëdhjetë:	Teknikat e transportit te peshkut
Java e trembëdhjetë:	Marketingu ne akuakulture
Java e katërbëdhjetë:	Restaurimi I akuakultures
Java e pesëmbëdhjetë:	Trendet globale dhe ato vendore te akuakultures
Plani i dizajnuar i mësimit: per Ushtrime	
Java	Ushtrimet që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje, njohja me principet e punes ne laborator dhe metodat e sigurise
Java e dytë:	Prezantim I paisjeve te ndryshme ne fushen e akuakultures
Java e tretë:	Kualiteti I ujit
Java e katërt:	Performanca e mjedisit
Java e pestë:	Nutricionizmi/ Pergatitja e ushqimit
Java e gjashtë:	Peshqit ne bazen dhe peshqit jasht tij
Java e shtatë:	Perceptimi I qendrueshmeris dhe kontributi ne shendetin publik
Java e tetë:	Kultivimi I karkalecave (film)
Java e nëntë:	Kultivimi I mishit te peshkut (film)
Java e dhjetë:	Grumbullimi I peshqve
Java e njëmbëdhjetë:	Procedurat e punes me elektropeshkim
Java e dymbëdhjetë:	Elektropeshkimi -ushtrim
Java e trembëdhjetë:	Vizite ne hudherat e ndryshme ne Kosove
Java e katërbëdhjetë:	Vizite ne hudherat e ndryshme ne Kosove
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi perfundimtar

--	--

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt i ligjëratis; Pritet që studentët të jenë të rregullt në ligjëratë dhe të jenë aktiv gjatë diskutimeve.

Pjesëmarrja aktive gjatë ligjërit do të merret parasysh gjatë vlerësimit.

Unë pres që studentët do të shpenzojnë pak kohë në reflektimin e asaj se çka kanë mësuar gjatë ligjëratis dhe diskutimeve.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore,		
Titulli i lëndës:	Biologji e konservimit		
Niveli:	Master		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	I, semestri 2		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Koha / lokacioni:	E mërkurë, 08.00-10.15, salla C		
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Agim Gashi		
Detajet kontaktuese:	044 113819, agim.gashi@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	Ky kurs ka të bëjë me konceptet e biologjisë së ruajtjes-konservimit dhe ndikimit të shkaktuar nga ndryshimet klimatike globale, pushtimin e ekosistemeve nga speciet e huaja, si dhe ndikimin antropogjen në degradimin dhe humbjen e ekosistemeve si dhe me mbrojtjen dhe menaxhimin e ekosistemeve..		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës Biologji e Konservimit është që të studiojë fenomenet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen, humbjen dhe restaurimin e diversitetit biologjik. Një theks i veçantë do të kushtohet aspekteve praktike të mbrojtjes dhe konservimit të resurseve natyrore biologjike.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojnë termat, faktet dhe konceptet që lidhen me biologjinë e ruajtjes • Zbatojnë konceptet e ruajtjes në jetën e përditëshme • Vlerësonin praktikën më të mira në menaxhimin e specieve të rrezikuara • Sintetizojnë të gjitha njohuritë rreth biologjisë së ruajtjes për dizajnimin e një plani për ruajtjen e ekosistemeve lokale • Zhvillojnë të menduarit kritik në kontekstin e planifikimit dhe menaxhimit të procesit të ruajtjes biologjike • Analizojnë degradimin e ekosistemit nga ndikimet e ndryshme si mbikullotja, zjarret, speciet pushtuese etj. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	1	15	15

Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	12	12
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	1	12	12
Detyra të shtëpisë	1	12	12
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	12	12
Përgaditja përfundimtare për provim	1	9	9
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	4	4
Projektet,prezentimet ,etj	1	4	4
Totali	11	113	125

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata tradicionale, zbatimi i strategjive të mësimdhënies dhe të nxënit ndërveprues të cilat nxisin të menduarit konstruktiv përmes leximit dhe shkrimit, punës në grupe, diskutimit, të mësuarit përmes projekteve, zgjedhjes së problemeve, punës laboratorike dhe në terren si dhe prezantime audiovizuale me diaproskop, videoprojektor, grafoskop, CD etj.
------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%
-----------------------	--

Literatura	
Literatura bazë:	1. Navjot S. Sodhi (2012) Conservation Biology for All, USA 2. W. P. Cunningham&M.A. Cunningham (2004): Principles of Environmental Sciences. McGraw-Hill
Literatura shtesë:	3. B. J. Nebel & R.T. Wright (2008): Environmental Science .Prentice Hall.Englewood Cliffs, New Jersey. USA 4. Richard B. Primack (2004) Essentials of Conservation Biology, USA

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Konservimi dhe Biologjia e konservimit
Java e dytë:	Biodiversiteti dhe konservimi?

<i>Java e tretë:</i>	Biodiversiteti i llojeve në kontekstin e konservimit
<i>Java e katërt:</i>	Biodiversiteti i ekosistemit dhe ai gjenetik
<i>Java e pestë:</i>	Zhdukjet masovike dhe ndryshimet globale
<i>Java e gjashtë:</i>	Proceset e zhdukjes
<i>Java e shtatë:</i>	Degradimi dhe humbja e ekosistemeve
<i>Java e tetë:</i>	Mbishfrytëzimi i biodiversitetit Vlerësimi i parë intermedier
<i>Java e nëntë:</i>	Llojet invazive-ekzotike
<i>Java e dhjetë:</i>	Mbrojtja e ekosistemeve
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Menagjimi i ekosistemeve
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Menagjimi i popullatave
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Konservimi Ex-situ dhe In-situ i biodiversitetit
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Principet e IUCN-së për mbrojtjen e llojeve
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Listat e Kuqe dhe Librat e Kuq Vlerësimi i dytë intermedier
Plani i dizajnuar i mësimimit:	
Ushtrimet	
Java	
<i>Java e parë:</i>	Analizimi i diversitetit të bashkësive I
<i>Java e dytë:</i>	Analizimi i diversitetit të bashkësive II
<i>Java e tretë:</i>	Analizimi i dallimit midis bashkësive I
<i>Java e katërt:</i>	Analizimi i dallimit midis bashkësive II
<i>Java e pestë:</i>	Hulumtim rreth listës së kuqe të llojeve të rrezikuara
<i>Java e gjashtë:</i>	Lista e kuqe të llojeve të bimëve në Kosovë
<i>Java e shtatë:</i>	Lista e kuqe të llojeve të bimëve në Kosovë – punë praktike në teren (rasti i Bjeshkëve të Nemuna).
<i>Java e tetë:</i>	Lista e kuqe të llojeve të kafshëve në Kosovë
<i>Java e nëntë:</i>	Lista e kuqe të llojeve të kafshëve në Kosovë – punë praktike në teren (rasti i Bjeshkëve të Nemuna).
<i>Java e dhjetë:</i>	Fragmentimi dhe degradimi i ekosistemeve – punë praktike në terren (rasti i Lumbardhit të Pejës).
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Zonat e mbrojtura: qasje sistematike drejt konservimit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Vlerat e konservimit: vlerësimi i qasjes së publikut (rasti i Parkut Kombëtar Mali Sharr)
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Prezantimi i punës praktike
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Prezantimi i punës praktike
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Prezantimi i punës praktike

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkycja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësim janë po ashtu të obligueshme.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore, Departamenti i Biologjisë, Programi: Ekologji dhe Mbrojtja e Mjedisit
Titulli i lëndës:	Bioremediimi
Niveli:	Master (MSc)
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II/3
Numri i orëve në javë:	2 +2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Hazbije Sahiti, prof. asoc.
Detajet kontaktuese:	Tel. +386 44 413 311 hazbije.sahiti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Bioremediimi përfshin aplikimin e organizmave të gjallë (p.sh. bimëve dhe mikroorganizmave) për të rehabilituar tokat dhe ujërat e kontaminuara.</p> <p>Si kurs hyrës, kursi përfshin një vërtetim të përgjithshëm për procesin e bioremediimit; përshkruan strategjitë tipike të bioremediimit për mjedisin e kontaminuar; zbulon aplikimet e teknologjive të bioremediimit; diskuton mbi faktorët që ndikojnë në shkallët e bioremediimit; si dhe prezanton rastet e suksesit në aplikimin e teknologjisë së bioremediimit në vendet e kontaminuara.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i këtij kursi është të prezantojë konceptet themelore biogjeokimike që kanë të bëjnë me remediimin e tokës dhe ujërave nëntokësore dhe të përshkruajë se si sistemet mund të projektohen me sukses për të mbështetur/promovuar remediimin me një theks të vecantë bioremediimin.</p> <p>Bioremediimi është një teknologji remediimi gjithnjë e më e përdorur që përdor agjentë biologjikë (mikroorganizma dhe bimë) për të trajtuar ndotësit e rrezikshëm në tokë dhe ujë; mund të çojë në largimin e përhershëm të ndotësve nga mjedisi; dhe mund të jetë teknike e lirë kur krahasohet me teknikat konvencionale. Është një teknologji multidisiplinare në zhvillim që përfshin mikrobiologjinë; inxhinierinë kimike, civile dhe mjedisore; dhe kiminë mjedisore, tokësore dhe analitike.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në përfundim të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Te identifikojë se cilët ndotës janë më shqetësues, të përshkruaj parimet e teknologjive të ndryshme të rehabilitimit fizik dhe kimik dhe të gjej lidhshshmerinë e përzgjedhjes së këtyre teknologjive me vetitë e ndotësve.

	<p>2. Te përcaktoje se çfarë nevojitet për karakterizimin e lokalitetit, të shpjegoj rëndësinë e përzgjedhjes së strategjive të përshtatshme të rehabilitimit, te përcaktojë se kur bioremediimi është një teknologji e përshtatshme dhe të pershkruje avantazhet dhe kufizimet e saj.</p> <p>3. Te përshkruajë ndërveprimet midis ndotësve, tokës dhe pranisë së një faze NAPL, ujit dhe mikroorganizmave dhe te shpjegojë se si kjo ndikon në fatin e ndotësit dhe disponueshmërinë e tij për biodegradim.</p> <p>4. Te llogarit kërkesat C:N:P dhe kërkesat e pranuesit terminal te elektroneve për biodegradim, te interpretojë kullën e elektronike dhe energjinë e fituar nga bashkimi i gjysmëreaksioneve të përshtatshme dhe te përshkruaje biodegradimin e ndotësve specifike si alkanet lineare, BTEXs, PAHs dhe komponimet e kluoruara si p.sh. PCE dhe PCB.</p> <p>5. Te shpjegojë se si të aplikohen teknikat e kultivueshme dhe jo të kultivueshme për studimet e biovlerësimit dhe biotretmanit.</p>
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/ Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	1	3	3
Totali	13		125
Metodologjia e mësimdhënies:			

	Ligjërata tradicionale, zbatimi i strategjive të mësimdhënies dhe të nxënit ndërveprues të cilat nxisin të menduarit konstruktiv përmes leximit dhe shkrimit, punës në grupe, diskutimit, të mësuarit përmes projekteve, zgjedhjes së problemeve, punës laboratorike dhe në terren si dhe prezantime audiovizuale me , videoprojektor, grafoskop, CD etj.
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i parë: 30%</p> <p>Vlerësimi i dytë 30%</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 7%</p> <p>Vijimi i rregullt 3%</p> <p>Provimi final 30%</p> <p>Total 100%</p> <p>Nota përfundimtare do të llogaritet si më poshtë</p> <p>51%- 60% = 6</p> <p>61% -70% = 7</p> <p>71% - 80% = 8</p> <p>81% - 90% = 9</p> <p>91%-100% =10</p>
Literatura:	
Literatura bazë:	1. Bioremediation: Principles and Applications, Ronald L. Crawford, Don L. Crawford, Cambridge University Press,2005
Literatura shtesë	<p>1. Microbial Biodegradation and Bioremediation, Surajit Das, Elsevier, 2014</p> <p>2. Ivankovic T, Mejdandzic M, Postic S, Malesevic N, Hrenovic J. Practical bioremediation course - laboratory exercises on biodegradation of cationic surfactant. J Microbiol Biol Educ. 2015 May 1;16(1):69-71.</p>

Plani i disejnuar i mësimit- Ligjeratat:	
Java	Ligjeratat që do të zhvillohen
Java e parë:	Koncepti dhe historiku i bioremediimit
Java e dytë:	Biodegradimi, bioremediimi, fitoremediimi
Java e tretë:	Metodat klasike të trajtimit dhe aplikimet e bioremediimit
Java e katërt:	Asgjësimi i ndotjes nga nafta me anë të bioremediimit
Java e pestë:	Vlerësimi i parë intermedier
Java e gjashtë:	Largimi i hidrokarbureve aromatike policiklike me anë të bioremediimit
Java e shtatë:	Largimi i komponimeve ksenobiotike me anë të bioremediimit
Java e tetë:	Largimi i metaleve të rënda me anë të bioremediimit

Java e nëntë:	Përdorimi i nanogrimcave në bioremediimin e ndotësve
Java e dhjetë:	Vlerësimi i dytë intermediar:
Java e njëmbëdhjetë:	Prodhimi i bioetanolit
Java e dymbëdhjetë:	Prodhimi i biodizelit
Java e trembëdhjetë:	Prodhimi i biogazit
Java e katërbëdhjetë:	Teknikat molekulare të përdorura në bioremediim
Java e pesëmbëdhjetë:	Kufizimet e bioremediimit
Plani i disajnuar i mesimit – Ushtrime laboratorike:	
Java	Ushtrimet laboratorike që do të mbahen
1.	Metodat e përdorura në ushtrimet laboratorike në kursin praktik të bioremediimit - Spektrofotometria
2.	Metodat e përdorura në ushtrimet laboratorike në kursin praktik të bioremediimit – Spektrometria e absorbimit atomik
3.	Ushtrimi laboratorik mbi biodegradimin e surfaktantit kationik- Disajnimi i eksperimentit
4.	Udhëzimet për siguri gjatë eksperimentit
5.	Përgatitja e medimeve që do të përdoren
6.	Përcaktimi i toksicitetit të surfaktantit kationik ndaj baktereve Përcaktimi i vlerës EC50 të klorurit të benzalkoniumit (BAC) në kulturën e pastër të <i>Micrococcus luteus</i> dhe kulturën e përzier të baktereve heterotrofike nga ujërat e zeza të vërteta komunale
7.	Përcaktimi i toksicitetit të surfaktantit kationik ndaj baktereve. Llogaritja e EC50 duke përdorur softuer
8.	Vlerësim intermediar
9.	Izolimi i baktereve që degradojnë BAC nga mjedisi
10.	Izolimi i baktereve që degradojnë BAC në medime të ngurta
11.	Simulimi i bioremediimit in situ
12.	Vlerësimi i rezultateve të eksperimentit
13.	Vlerësim intermediar

14	Vizitë në Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Zeza në Prizren
15.	Prezentimi i bioremediimit me animacione

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësime janë po ashtu të obligueshme.

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore		
Titulli i lëndës:	Diversiteti i Faunës së Kosovës		
Niveli:	Master		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti I, semestri 2		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Koha / lokacioni:	E enjte, 14.00-15.30, Laboratori i Zoologjisë		
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Halil Ibrahim		
Detajet kontaktuese:	044240225, halil.ibrahimi@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	<p>Kjo lëndë përmbanë informata rreth diversitetit të faunës në Republikën e Kosovës. Aspektet filogjenetike e zoogeografike të diversitetit të faunës së Kosovës në kontekstin më të gjerë ballkanik dhe evropian do të diskutohen. Do të ofrohen të dhëna rreth zonave të caktuara në Republikën e Kosovës të cilat karakterizohen me diversitet më të lartë shtazor për grupe të ndryshme taksonomike. Rreziqet që i kanosen diversitetit të grupeve të caktuara të shtazëve në territorin e Kosovës do të shqyrtohen gjithashtu.</p>		
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i kësaj lënde është që të krijojë njohuri tek studentët rreth aspekteve të faunës së Kosovës si dhe t'i aftësojë ata rreth hulumtimit të disa grupeve taksonomike në Kosovë.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillojnë njohuri fundamentale rreth llojeve të kafshëve prezente në Kosovë. • Kuptojnë rëndësinë dhe mënyrat e ruajtjes e mbrojtjes së faunës në Kosovë • Identifikojnë zonat me pasurinë më të madhe llojore të faunës në Kosovë. • Integrojnë njohuritë e tyre nga biologjia në mbrojtjen e faunës në Kosovë. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënimit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej

Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	0	0	0
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	5	10
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	1	9	9
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	5	10
Projektet,prezentimet ,etj	2	3	6
Totali	15	73	125

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në laborator dhe terren, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%
Literatura	
Literatura bazë:	1. Balkan Biodiversity: Pattern and Process in the European Hotspot, edited by Huw I. Griffiths, Boris Kryštufek, Jane M. 2013
Literatura shtesë:	1. Marine, Freshwater, and Wetlands Biodiversity Conservation., edited by David L. Hawksworth, Alan T. Bull, 2006 2. Rivers of Europe By Klement Toekner, Urs Uehlinger, Christopher T. Robinson, 2009 3. Libri i Kuq i Faunës së Kosovës, Halil Ibrahim et al., 2019, MESP, Prishtinë.

Plani i dizajnuar i mësim:

Ligjëratat	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Principet e zoodiversitetit
<i>Java e dytë:</i>	Diversiteti shtazor në Evropë dhe Ballkan
<i>Java e tretë:</i>	Karakteristikat e faunës së Kosovës I
<i>Java e katërt:</i>	Karakteristikat e faunës së Kosovës II
<i>Java e pestë:</i>	Gjitarët në Kosovë
<i>Java e gjashtë:</i>	Reptilët në Kosovë
<i>Java e shtatë:</i>	Llojet invazive ne Kosove Vlerësimi i parë intermedier
<i>Java e tetë:</i>	Përhapja e invertebrorëve në Kosovë
<i>Java e nëntë:</i>	Diversiteti i peshqve në Kosovë
<i>Java e dhjetë:</i>	Përhapja e molusqeve në Kosovë
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Kërcënimet ndaj zoodiversitetit në Kosovë
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Kosova dhe principet zoogjeografike
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Libri i Kuq i Faunës së Kosovës
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Hotspotet e biodiversitetit në Kosovë
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i diversitetit llojor në Kosovë Vlerësimi i dytë intermedier
Plani i dizejnuar i mësimit: Ushtrimet	
Java	
<i>Java e parë:</i>	Metodologjia e mbledhjes së të dhënave rreth llojeve të faunës në Kosovë
<i>Java e dytë:</i>	Mbledhja e të dhënave rreth diversitetit të gjitarëve në Kosovë
<i>Java e tretë:</i>	Mbledhja e të dhënave rreth diversitetit të reptilëve në Kosovë
<i>Java e katërt:</i>	Mbledhja e të dhënave rreth diversitetit të amfibeve në Kosovë
<i>Java e pestë:</i>	Mbledhja e të dhënave rreth insekteve në Kosovë
<i>Java e gjashtë:</i>	Mbledhja e të dhënave rreth fluturave të ditës në Kosovë
<i>Java e shtatë:</i>	Mbledhja e të dhënave rreth trichopterave në Kosovë
<i>Java e tetë:</i>	Mbledhja e të dhënave rreth plecopterave në Kosovë
<i>Java e nëntë:</i>	Mbledhja e të dhënave rreth molusqeve në Kosovë
<i>Java e dhjetë:</i>	Diversiteti i faunës në zonat e mbrojtura
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Llojet e faunës së Kosovës në listat e kuqe
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Prezantimi i seminareve
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Prezantimi i seminareve
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Prezantimi i seminareve
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i diversitetit llojor në Kosovë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësim janë po ashtu të obligueshme.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
Titulli i lëndës:	Ekofiziologji
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obliguese
Viti i studimeve:	Viti par/semestri veror
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Departamenti i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Behxhet Mustafa, Prof. dr. Kemajl Bislimi
Detajet kontaktuese:	behxhet.mustafa@uni-pr.edu, kemajl.bislimi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Në këtë kurs, studentët do të njihen me proceset dhe mekanizmat themelorë fiziologjik (bimëve dhe kafshëve) dhe faktorët ekologjikë. Vëmendje e veçantë do ti kushtohet veprimt të faktorëve ekologjik në procese fiziologjike dhe adaptimit të bimëve dhe kafshëve ndaj këtyre faktorëve. Po ashtu studentëve do të ju ofrohet mundësia e majtës së faktorëve ekologjik dhe proceseve fiziologjike më qëllim të vlerësimit të ndikimit të tyre në procese fiziologjike. Rezultatet e mbledhura do të përpunohen dhe analizohen nga studentët dhe të njëjtat do të prezantohen para grupeve punuese.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kursi ka për qëllim familjarizimin e studentëve me konceptet dhe teknikat themelore që përdoren në ekofiziologji, në mënyrë që ata të kuptojnë mekanizmin fiziologjik të reagimit të bimëve dhe kafshëve në mjedisin e tyre.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit studentët do të jenë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none">- Analizojnë parimet dhe konceptet themelore ekofiziologjike dhe t'i zbatojnë ato për të interpretuar proceset fiziologjike të bimëve dhe kafshëve në raport me mjedisin e tyre.

	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësojnë dhe krahasojnë ndikimin e faktorëve të ndryshëm mjedisorë, si temperatura, disponueshmëria e ujit, disponueshmëria e oksigjenit dhe kripësia, në proceset fiziologjike. - Kryejn eksperimente për të vlerësuar efektet e streseve mjedisore në bimët dhe kafshët dhe përdorin teknika të përshtatshme analitike për të vlerësuar dhe interpretuar të dhënat. - Vlerësojnë në mënyrë kritike rëndësinë e përshtatjeve fiziologjike në kontekstin e seleksionimit natyror dhe evolucionin e organizmave në përgjigje të ndryshimeve mjedisore. - Demonstrjnë aftësi në përdorimin e metodave dhe mjeteve të zakonshme për kërkimin, analizën dhe interpretimin e përshtatjeve fiziologjike, si mikroskopi, analizat biokimike dhe teknikat molekulare. - Përdorni gjuhën e duhur shkencore për të sintetizuar dhe komunikuar në mënyrë efektive gjetjet dhe përfundimet shkencore në ekofiziologji.
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	8	1	8
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	0	0	0
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	5	4	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	1	2
Projektet,prezantimet ,etj	2	1	2
Totali			126

Metodologjia e	Kursi do të realizohet përmes kombinimit të: ligjëratave
-----------------------	--

mësimdhënies:	tradicionale, mësimi interaktiv me studentin në qendër, punës në grupe, seminareve, debate, konsultime, punë praktike në terren dhe laborator, etj.
Metodat e vlerësimit:	<p>Do të bëhet vlerësim i vazhdueshëm i të gjitha aktiviteteve të studentit, puna në terren, puna në laborator, shkathtësitë manovruese me aparate dhe instrumente laboratorike etj.,</p> <p>Vlerësimi bëhet në pjesën praktike dhe teorike, përmes vlerësimeve intermediere dhe provimit përfundimtar.</p> <p>Vlerësimi intermediar: 30%</p> <p>Seminaret: 10%</p> <p>Pjesëmarrja : 10%</p> <p>Provimi final: 50%</p> <p>Totali: 100%</p> <p>Nota do të llogarite si më poshtë:</p> <p>51%- 60% = 6</p> <p>61% -70% = 7</p> <p>71% - 80% = 8</p> <p>81% - 90% = 9</p> <p>91%-100% =10</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Hoxha, E., (2005) Ekofiziologjia e bimëve. Dispensë Universiteti i Prishtinës. Prishtinë. - Miho, A., Shuka, L. (2003): Fiziologjia e bimëve. Tiranë - Bradshaw, D., Vertebrate Ecophysiology, An Introduction to its Principles and Applications, University of Western Australia, Perth, 2006. - Vinod V., Biological Rhythms, Academia Press, 2002
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Lambers, Hans, Chapin III, F. Stuart, Pons, Thijs L. (2008) Plant Physiological Ecology. Springe - Lincoln Taiz, Eduardo Zeiger, Ian M. Møller, and Angus Murphy Plant Physiology and Development, Sixth Edition, Sinauer Associates. - Paolo Sassone-Corsi, Yves Christen "A time for metabolism and hormones" USA, France, 2016 - H. Dingle "Migration: The Biology of Life on the Move" Oxford Press. 1996. - Renfree MB, Shaw B. "Diapause". Annual

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Homeostaza si problem i ekofiziologjisë
<i>Java e dytë:</i>	Aspektet ekofiziologjike të ritmeve biologjike ditore
<i>Java e tretë:</i>	Aspektet ekofiziologjike të ritmeve biologjike sezonale
<i>Java e katërt:</i>	Aspektet ekofiziologjike të gjumit dimëror dhe diapauzës
<i>Java e pestë:</i>	Sjellja e organizmave gjatë hipoksionit
<i>Java e gjashtë:</i>	Termorregullimi në kushte të temperaturave të ndryshme
<i>Java e shtatë:</i>	Mbijetesa e organizmave në ambiente polare dhe shkretinore
<i>Java e tetë:</i>	Migrimi dhe mosshqyeshmeria e organizmave shtazor Vlerësimi i parë intermediar
<i>Java e nëntë:</i>	Fiziologjia e bimëve nën veprimin e faktorëve stresues
<i>Java e dhjetë:</i>	Regjimi ujqorë në bimë, dhe rëndësia e saj ekologjike. Adaptimet e fiziologjike ndaj ujit si faktorë ekologjik
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Shtypja osmotike dhe përqendrimi i lëngut qelizor. Adaptimet e fiziologjike ndaj salinitetit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Fotosinteza. Adaptimet e fiziologjike ndaj dritës si faktorë ekologjik
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Frymëmarrja Adaptimet e fiziologjike ndaj stresit të anoksisë dhe mungesës së CO ₂
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Produktivitetit i bimëve, Faktorët stresues që ndikojnë në produktivitet
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Adaptimet e fiziologjike ndaj faktorëve ekologjik Vlerësimi i dytë
Java	Ushtrimet që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Protokoli eksperimental në ekofiziologji
<i>Java e dytë:</i>	Testi i fitnesit-homeostaza e gazrave dhe frymëmarrjes
<i>Java e tretë:</i>	Ndikimi i ritmeve cirkadiane në parametrat biokimik dhe enzimatik
<i>Java e katërt:</i>	Efektet e uljes së temperaturave dhe shtangimi dimëror tek amfibet
<i>Java e pestë:</i>	Simulimi i diapauzës tek insektet
<i>Java e gjashtë:</i>	Kriptobioza (Polypedilum vanderplanki) si formë e tejkalimit të kushteve ekstreme
<i>Java e shtatë:</i>	Metodat e percjelljes së migrimeve tek shpendët
<i>Java e tetë:</i>	Ndikimi i temperaturës në shtazët poikiloterme
<i>Java e nëntë:</i>	Metodat që përdoren për matjen ekofiziologjike në bimë (procese fiziologjike dhe faktorëve ekologjik)
<i>Java e dhjetë:</i>	Matja e intensitetit të transpirimit në bimë
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Matja e shtypjes osmotike dhe përqendrimit të lëngut qelizor
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Matja e sasisë së klorofilit dhe fluoreshencës së tij.

<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Matja e intensitet të frymëmarrjes në bimë
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Punë në terren
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Përpunimi i rezultateve nga puna në terren dhe prezantimi i tyre.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata, marrin pjese ne vizita studimore ne terren(ekskursion). Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësime po ashtu janë obligative.

SYLLABUS i Lëndës Ekogjenetikë (Master: drejtimi Ekologji Mbrojtje e Mjedisit)

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, Departamenti i Biologjisë, Drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit
Titulli i lëndës:	Ekogjenetikë
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i I-rë, semestri veror
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	E Enjte, 16- 17 ³⁰
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Sc. Avdulla J. Alija, Prof. i rregullt Dr. Sc. Fisnik Asllani, Asistent
Detajet kontaktuese:	Dhoma nr. 55, tel.: 038-249-872 lok. 225, e-mail.: avdulla.alija@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Kjo lëndë përfshin aspektet gjenetike dhe ekologjike të biologjisë evolucioniste. Trajton burimin dhe mbajtjen e variacionit gjenetik duke marrë shembuj nga prokariotët, bimët, shtazët dhe njeriu. Temat e ligjëratave përfshijnë edhe gjenetikën e popullacionit, gjenetikën kuantitative si dhe tema tjera aktuale si gjenetika e konservimit.
Qëllimet e lëndës:	Të kuptohen proceset gjenetike në nivel të popullacionit; Të kuptohen forcat evolutive-mekanizmat dhe pasojat e veprimit të tyre; Të aftësohen studentët për aplikimin e parimeve të gjenetikës ekologjike në problemet me të cilat ballafaqohet shoqëria njerëzore.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studenti fiton njohuritë dhe shkathtësitë në vijim: <ul style="list-style-type: none"> • Kupton proceset gjenetike në nivel të popullacionit; • Njih forcat evolutive dhe shpjegon mekanizmat dhe pasojat e veprimit të tyre; • Përshkruan dhe analizon veçoritë e trashëgimisë së veçorive fenotipore të kontrolluara nga shumë lokuse gjenesh; • Njih mekanizmat e mbajtjes së variacionit gjenetik në popullacionet natyrore; • Aplikon parimet e gjenetikës ekologjike në problemet me të cilat ballafaqohet shoqëria njerëzore .

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30/semester
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30/semester
Punë praktike	//////	//////	////////
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	////////	//////	10/semester
Ushtrime në teren	//////	//////	//////
Kollokfume,seminare	//////	////////	10/semester
Detyra të shtëpisë	//////	//////	//////
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	//////	////////	30/semester
Përgaditja përfundimtare për provim	////////	//////	5/semester
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	////////	//////	5/semester
Projektet,prezentimet ,etj	////////	////////	5/semester
Totali			125/semester
Metodologjia e mësimdhënies:	Një ligjeratë dhe një ushtrim teorik në javë në kuader të të cilave do të zhvillohen bashkëbisedime grupore, seminare, dhe ushtrime teorike.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Conner, C.K., and Hartl, D.L. (2004). A primer of Ecological Genetics. Sinauer Associates, Inc. Sunderland, Massachusetts, USA 2. Gjenetika Ekologjike (material nga ligjeratat dhe ushtrimet) 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Hamilton, Matthew B.(2021) <i>Population genetics</i>. John Wiley & Sons. 2. Real, A. L. (1994). Ecological Genetics. Princeton Univ. Press. Lynch, M 3. Burime të ndryshme nga Interneti 		

Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në gjenetikën ekologjike
<i>Java e dytë:</i>	Diversiteti gjenetik dhe ekologjik
<i>Java e tretë:</i>	Variacioni gjenetik-markerët gjenetikë
<i>Java e katërt:</i>	Ekulibri i Hardy-Weinbergut I
<i>Java e pestë:</i>	Ekulibri i Hardy-Weinbergut II
<i>Java e gjashtë:</i>	Çiftëzimi jo i rastësishëm, inbridingu
<i>Java e shtatë:</i>	Mutacioni, migrimi, drifti gjenetik. <i>Vlerësimi i parë</i>
<i>Java e tetë:</i>	Madhësia efektive e populacionit, F-statistika, Vlera adaptive
<i>Java e nëntë:</i>	Interaksionet në mes forcave evolutive
<i>Java e dhjetë:</i>	Gjenetika kuantitative
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Kuantifik. i veprimit të gjeneve, heritabiliteti,
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Seleksioni, speciacioni dhe evolucioni
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Ekogjenetikë e aplikuar I - Gjenetika e konservimit. <i>Vlerësimi i dytë</i>
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Ekogjenetikë e aplikuar II- Evolucioni i llojeve invazive
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Gjenotoksikologji Mjedisore

Java	Ushtrimi teorik apo puna praktike/laboratorike që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Teoria e gjasës dhe statistika në Gjenetikën Ekologjike
<i>Java e dytë:</i>	Teoria e gjasës dhe statistika në Gjenetikën Ekologjike
<i>Java e tretë:</i>	Variacioni gjenetik; markerët gjenetikë
<i>Java e katërt:</i>	Ekulibri i Hardy-Weinbergut I
<i>Java e pestë:</i>	Ekulibri i Hardy-Weinbergut II
<i>Java e gjashtë:</i>	Gjenetika e populacionit; llogaritja e frekuencës së aleleve
<i>Java e shtatë:</i>	Gjenetika e populacionit; Faktorët që prishin ekuilibrin gjenetik
<i>Java e tetë:</i>	Mutacioni, migrimi, drifti gjenetik
<i>Java e nëntë:</i>	Migrimi, drifti gjenetik
<i>Java e dhjetë:</i>	Seleksioni
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Gjenetika kuantitative; trashëgimia e veçorive poligjenike
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Seleksioni artificial, heritabiliteti
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Frekuenca e aleleve për lokuse të zgjedhura në populacionin human të Kosovës; mbledhje dhe përpunim i të dhënave
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Frekuenca e aleleve për lokuse të zgjedhura në populacionin human të Kosovës; mbledhje dhe përpunim i të dhënave
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Frekuenca e aleleve për lokuse të zgjedhura në populacionin human të Kosovës; mbledhje dhe përpunim i të dhënave

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Sjelljet penguese në sallën e mësimit apo në laborator, janë të papranueshme.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
Titulli i lëndës:	Ekologji e aplikuar
Niveli:	MSc.
Statusi lëndës:	Obliguese
Viti i studimeve:	Vitit parë/ semestri dimëror
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Departamenti i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Avni Hajdari
Detajet kontaktuese:	avni.hajdari@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Studentë do të njihen me parimet ekologjike, strukturën dhe funksionimin e ekosistemeve, si dhe mundësitë e aplikimit të tyre për zgjidhjen e problemeve praktike si p.sh. menaxhimi i ekosistemeve, shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore dhe biodiversitetit, konservimi biologjik, restaurimin e llojeve dhe ekosistemeve të degraduara, diversitetit kulturor, vlerësimi i ndikimit në mjedis etj. Vëmendje e veçantë do të kushtohet parimeve, proceseve dhe metodave që përdoren për vesimin e ndikimit në mjedis.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kursi synon t'i aftësojë për të aplikuar njohuritë ekologjike në zgjidhjen e problemeve ekologjike dhe mjedisore dhe për të nxitur ide të reja, përfshirë këtu menaxhimin adaptive të ekosistemeve dhe burimeve natyrore, si dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit studentet do të jenë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none">- Analizojë në mënyrë kritike strukturën dhe mekanizmat funksionalë të modeleve të ndryshme të ekosistemit, duke vënë theksin në ruajtjen e homeostazës ekologjike.- Zbatojnë parimet ekologjike për të adresuar problemet komplekse të botës reale.- Vlerësojnë rolin e produktivitetit organik në ekosistemet artificiale dhe implikimet e tij për sigurinë dhe qëndrueshmërinë ushqimore të njerëzve.- Hulumtojnë sfidat e kontrollit të dëmtuesve dhe rëndësinë e strategjive të menaxhimit të

	<p>integruar të dëmtuesve për ekuilibrin ekologjik.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorin qasje ekologjike për të identifikuar, vlerësuar dhe trajtuar çështjet e menaxhimit të mjedisit dhe ekosistemit. - Integrojnë proceset e menaxhimit adaptiv të ekosistemeve dhe parimet e vlerësimit të ndikimit në mjedis - Në mënyrë efektive komunikojnë dhe informojnë vendimmarrësit dhe politikë bërësit.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	10	20
Ushtrime në terren	8	2	16
Kollokfume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			0
Koha e studimit vetanak të studentit	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	10	3	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
Projektet,prezantimet ,etj	2	3	6
Totali			125

<i>Java e nëntë:</i>	Vegjetacioni potencial natyral i Kosovës, shtrirja horizontale dhe vertikale e vegjetacionit të Kosovës
<i>Java e dhjetë:</i>	Klasifikimi i vegjetacionit të Kosovës
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Kl. <i>Quercus-Fagetea</i> , Kl. <i>Alnetea glutinosae</i> , Kl. <i>Salicetea purpureae</i> , Kl. <i>Vaccinio-Piceetea</i> në vegjetacionin e Kosovës
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Kl. <i>Erico-Pinetea</i> , Kl. <i>Asplenieta trichomanis</i> , Kl. <i>Betulo-Adenostyletea</i> , Kl. <i>Epilobietea angustifolii</i> , në vegjetacionin e Kosovës
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Kl. <i>Drypetea spinosae</i> , Kl. <i>Festuco-Seslerietea</i> , Kl. <i>Juncetea trifidi</i> , Kl. <i>Salicetea herbacea</i> në vegjetacionin e Kosovës
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Kl. <i>Molinio-Arhenatheretea</i> , Kl. <i>Festuco-Brometea</i> , Kl. <i>Festucetea vaginatae</i> , Kl. <i>Thero-Brachypodietea</i> në vegjetacionin e Kosovës
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kl. <i>Scheucherio-Caricetea fuscae</i> , Kl. <i>Phragmitetea</i> , Kl. <i>Potametea</i> , Kl. <i>Chenopodietea</i> në vegjetacionin e Kosovës Vlerësimi i dytë

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ushtrimet* që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Organet vegetative bimore
<i>Java e dytë:</i>	Organet riprodiktive bimore
<i>Java e tretë:</i>	Determinimi (përcaktimi) i bimëve me anë të çelësit (përcaktuesit) të florës
<i>Java e katërt:</i>	Determinimi (Përcaktimi) i familjeve të <i>Pteridophyta</i> -ve
<i>Java e pestë:</i>	Çelësi për determinimin e familjeve të <i>Pinophytave</i>
<i>Java e gjashtë:</i>	Çelësi për determinimin e familjeve të <i>Magnoliophytave</i>
<i>Java e shtatë:</i>	Dikotiledonet dhe monokotiledonet (Karakteristikat dhe dallimet e tyre)
<i>Java e tetë:</i>	Bimët endemike, mjekësore dhe aromatike të Kosovës (disa shembuj)
<i>Java e nëntë:</i>	Praktika e përgatitjes dhe e ruajtjes së mostrave bimore në herbarium (disa shembuj në praktikë) <u>Vlerësimi i parë</u>
<i>Java e dhjetë:</i>	Morfologjia e fitocenzës-cilësitë analitike dhe sintetike (nga teoria në praktikë)
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Rilevimet fitocenzologjike
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Tabela fitocenzologjike
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Sintaksonomia e fitocenzave
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Format jetësore (biologjike)
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Spektrat e fitocenzës Vlerësimi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Studentët duhet të jenë të rregullt në mësim, aktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, të përgatiten, të jenë në gjendje të marrin të dhëna nga interneti, të bëjnë pyetje gjatë seancave mësimore. Duhet të mbajnë disiplinë, t'i shkyçin telefonat celular, të vijnë me kohë në ligjëratat dhe në ushtrime dhe mos të pengojnë mbarëvajtjen e mësimit.

**Disa ushtrime mund të realizohen në teren, sipas mundësive reale teknike (një ose disa ushtrime brenda ditës)*

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore
Titulli i lëndës:	Kimia analitike dhe instrumentale
Niveli:	Mater/Msc
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Parë/Parë (I/I)
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	E martë 08.00 –09.30, Departamenti i kimisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. ass. Jeton Halili
Detajet kontaktuese:	jeton.halili@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Kursi fillon me mënyrat e mostrimit, matjeve në kimi analitike dhe përpunimin statistikor të rezultateve. Pjesa e dytë do të mbulohet nga titullimet acido-bazike, kompleksometrike dhe redokse. Në vazhdim të kursit do të ofrohen metoda themelore të analizës gravimetrike. Pjesa kryesore përfshinë metodat instrumentale të analizës kimike; si: spektrofotometrinë, absorbimin atomik dhe metodat elektrokimike. Në përmbyllje mbulohen teknikat bazë të ndarjes duke përfshirë kromatografinë. Teoria do të përcillet me punë praktike në laborator duke përdorur një gamë të gjerë të shembujve tipikë.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kimi analitike është kurs që kombinon leksionet me diskutime që përdor metoda aktive të mësimin dhe pjesën laboratorike. Studentët në këtë kurs do t'i ekspozohen teorisë dhe praktikës së analizave kimike sasiore dhe ekuilibrave kimikë. Në seanca e diskutimeve, do të përdoren metodat e mësimin aktiv dhe të njëjtat do të përfshihen në ligjërata, në përputhje me shumë studime të kohëve të fundit mbi atë se si studentët akumulojnë njohuritë. Ligjëratat do të përcillen me aktivitete praktike në punë laboratorike duke u dhënë studentëve një eksperiencë praktike mbi temat e mbuluara në kimi analitike.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Analizojnë konceptet e saktësisë dhe precizitetit dhe identifikojnë metodat statistikore për të analizuar të dhënat me një shumëllojshmëri të teknikave analitike.2. Vlerësojnë parimet sasiore të ekuilibrit të tretësirave ujore dhe aplikojnë ato në probleme të ndryshme në kimi analitike, duke përfshirë komplekset metal-ligand.3. Krijojnë një strategji efektive për t'u përqendruar në regjionet e përgjigjes lineare të teknikave spektrofotometrike, duke marrë parasysh faktorët e

	ndikimit si: ndjeshmëria, kufijtë e detektimit dhe interferencat.
	4. Analizojne metodat elektrokimike si potentiometria, kulometria dhe voltametria dhe identifikojne parimet e tyre themelore.
	5. Vleresojne aplikimet e ndryshme të metodave kromatografike.
Kontributi në ngarkesën e studentit	
Aktiviteti	Orë Ditë/javë Gjithsej
Ligjërata	2 15 30
Ushtrime teorike/laboratorike	2 15 30
Punë praktike	1 5 5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2 5 10
Ushtrime në teren	2 2 4
Kollokfiume,seminare	2 2 4
Detyra të shtëpisë	1 3 5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2 13 26
Përgatitja përfundimtare për provim	1 5 5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2 2 4
Projektet, prezantimet ,etj	2 1 2
Totali	125
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjëratë, punë laboratorike, punë seminari dhe individuale.
Metodat e vlerësimit:	<i>Vlerësimi i parë:</i> 25% <i>Vlerësimi i dytë:</i> 30% <i>Detyrat e shtëpisë dhe seminarët:</i> 5% <i>Vijimi i rregullt:</i> 5% <i>Provimi final:</i> 35% <i>Total:</i> 100% Vlerësimi final me note do të bëhet si vijon: 51%- 60% = 6 61% -70% = 7 71% - 80% = 8 81% - 90% = 9 91%-100% =10
Literatura	
Literatura bazë:	1. Quantitative Chemical Analysis, Daniel C. Harris, 8th edition, W. H. Freeman and Company, 2010. 2. A. Fundamentals of Analytical Chemistry, 9th Ed.

	Douglas A. Skoog, Donald M. West, F. James Holler, Stanley R. Crouch (2014). Thomson Learning
Literatura shtesë:	1. Douglas A. Skoog, F. James Holler, Timothy A. Nieman: Principles of Instrumental Analysis, 1998

Plani i dizajnuar i mësimi - Ligjëratat:	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Marrje mostrave, gabimet eksperimentale, preciziteti dhe saktësia.
<i>Java e dytë:</i>	Analizat statistikore dhe kalibrimet në kimi analitike.
<i>Java e tretë:</i>	Reaksionet acido-bazike, pufuret, hidroliza e kriperave, produkti i tretshmerise
<i>Java e katërt:</i>	Ekulibrat kimikë
<i>Java e pestë:</i>	Ekulibrat dhe titullimet për sistemet acid-bazë
<i>Java e gjashtë:</i>	Ekulibrat dhe titullimet për sistemet kompleksoformuese
<i>Java e shtatë:</i>	Ekulibrat dhe titullimet për sistemet redokse
<i>Java e tetë:</i>	Metodat gravimetrike të analizës kimike
<i>Java e nëntë:</i>	Metodat vëllimetrike të analizës kimike
<i>Java e dhjetë:</i>	Spektrofotometria, spektrofotometria UV-Vis,
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Spektroskopia atomike
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Metodat elektroanalitike, elektroliza dhe kulometria, polarografia dhe potenciometria
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Metodat për ndarje në kimi analitike, kromatografia
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Kromatografia e gaztë
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kromatografi e lëngët
Përmbajtja laboratorike:	
Nr.	Një përzgjedhje (rreth 10) e eksperimenteve të mëposhtme do të kryhet në laborator.
1.	Statistikat në kimi analitike
2.	Studim i hollësishëm për ekuilibrat kimikë
3.	Titullimet Acid-Bazë
4.	Titullimet kompleksometrik
5.	Titullimet redokse
6.	<i>Analiza gravimetrike higroskopike</i>
7.	Percaktimi gravimetrik i përqendrimit të thiosulfateve
8.	Potentiometri – Electrodat Jon - Selektive
9.	Percaktimi spektrofotometrik i manganit dhe kromit në një përzierje
10.	Percaktimi i bakrit me fotometri me flakë (SFAA)
11.	Percaktimi i hekurit në drithëra me SAA
12.	Percaktimi i metaleve gjurmë në flokë me SAA
13.	Analiza e tretësve dhe ngjyrave industriale me GC
14.	Analiza e kafeinës në pije me HPLC

15	Analiza e kapsaicinoideve me HPLC me faza reverse
----	---

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Kursi mund të regjistrohet pas përfundimit të obligimeve nga lëndët e mëparshme në vitin e parë të studimit. Vijimi i rregullt i studentëve në ligjëratat dhe në ushtrime është i obligueshëm. Secili student duhet të përgatisë dhe të shkruajë raportin laboratorik plotësisht i pavarur. Gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve shkyçja e telefonave është e domosdoshme.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
Titulli i lëndës:	Legjislacioni dhe politikat mjedisore
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obliguese
Viti i studimeve:	Viti i dytë/semestri i dimëror
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Departamenti i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Behxhet Mustafa
Detajet kontaktuese:	behxhet.mustafa@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Gjatë shtjellimi të kursit studentët do të njihen me sistemet institucionale të menaxhimit mjedisor në nivel global, evropian dhe lokal. Po ashtu ata do të njihen me mekanizmat ligjor, politik dhe financiar global, evropian dhe lokal për menaxhimin e mjedisit, konventat dhe protokollat ndërkombëtare, obligimet kryesore të shteteve në raport me konventat mjedisore dhe direktivat e BE, legjislacionin dhe gjendjen aktuale të menaxhimit të mjedisit në Kosovë
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi është që studentëve të ju mundësoj zgjerimin njohurive për sistemet lokale, rajonale dhe globale që lidhen me legjislacionin, politikën, strategjitë dhe mekanizmat financiare për menaxhimin e mjedisit dhe natyrës.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kursit studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> - Kuptojnë politikën, legjislacionin, strategjitë dhe institucionet e përfshira në mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit në Kosovë, Bashkimin Evropian dhe globalisht. - Krahasojnë mekanizmat legjislativë globalë, evropianë dhe vendorë për mbrojtjen e mjedisit. - Identifikojnë dhe dikutojnë detyrimet kryesore të palëve në lidhje me konventat mjedisore dhe direktivat e BE-së. - Përshkruajnë kornizat legjislative dhe mekanizmat që mbështesin përpjekjet për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit. - Shpjegojnë rolet dhe përgjegjësitë e organeve administrative në mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit, si dhe proceset e tyre vendimmarrëse.

	- Anlaizojnë, vlerësojn dhe propozojn rekomandime për përmirësimin e situatës së menaxhimit mjedisor në Kosovë bazuar në rastet studimore, hulumtimet dhe praktikatat më të mira.		
Aktiviteti	Orë	Javë	Totali
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në terren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	8	24
Përgatitja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
Projektet,prezantimet ,etj	4	1	4
Totali			126
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata tradicionale, mësim interaktiv me studentin në qendër, punë në grupe , seminare, debate, konsultime, punë praktike në terren dhe laborator , tryezë e rumbullakët etj.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Do të behet vlerësim i vazhdueshëm i te gjitha aktiviteteve te studentit, puna në terren, puna në laborator, shkathtësitë manovruese me aparate dhe instrumente laboratorike etj.,</p> <p>Vlerësimi bëhet në pjesën praktike dhe teorike, përmes vlerësimeve intermediere dhe provimit përfundimtar.</p> <p style="text-align: right;">Vlerësimi intermedier: 30%</p> <p style="text-align: right;">Pjesëmarrja 10%</p> <p style="text-align: right;">Seminaret: 20%</p> <p style="text-align: right;">Provimi final: 40%</p> <p style="text-align: right;">Totali: 100%</p> <p>Nota do të llogarite si më poshtë:</p> <p style="text-align: right;">51%- 60% = 6</p> <p style="text-align: right;">61% -70% = 7</p>		

	<p>71% - 80% = 8</p> <p>81% - 90% = 9</p> <p>91%-100% =10</p>
Literatura bazë:	- Zeqir Veselaj, Behxhet Mustafa, Sistemi i Politikave Mjedisore. WUS-Austria, Prishtinë 2009
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Folmer, H & Gabel L.H. (2000). Principles of Environmental and Resources Economics. Edward Elgar Publishing Inc. Northampton, Massachusetts, USA. - Charles-Hubert Born, An Cliquet, Hendrik Schoukens, Delphine Misonne, Geert Van Hoorick. The Habitats Directive in its EU Environmental Law Context: European Nature's Best Hope? Routledge 2017.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje, terminologjia themelore që lidhet me ligjet mjedisore dhe filozofia mjedisore.
<i>Java e dytë:</i>	Institucionet globale të menaxhimit të mjedisit dhe biodiversitetit
<i>Java e tretë:</i>	Aspektet ligjor ndërkombëtar për mbrojtje të mjedisit dhe natyrës
<i>Java e katërt:</i>	Konventa dhe direktivat kryesore për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës: Konventa mbi Diversitetin Biologjik dhe Konventa e CITES dhe Konventa e Bernit- mbi konservimin e florës dhe faunës së egër në Evropë
<i>Java e pestë:</i>	Trashëgimia Botërore dhe ligatinat: Konventa mbi Trashëgiminë Botërore dhe Konventa RAMSAR dhe Konventa e Bonit mbi Speciet Migratore
<i>Java e gjashtë:</i>	Aksidentet industriale ndërkufitare: Konventa e Helsinkit, Konventa e ESPOO- dhe Konventa e PIC
<i>Java e shtatë:</i>	Ndotja ndërkufitare e ajrit dhe ujërave: Konventa e Gjenevës (LTARP) dhe Konventa e Helsinkit Vlerësimi intermedier
<i>Java e tetë:</i>	Kimikatet, mbeturinat dhe pjesëmarrja e publikut: Konventa e POP-s , Konventa e Bazel-it dhe Konventa e Aarhusit
<i>Java e nëntë:</i>	Ndotja e ajrit dhe ndryshimet klimatike: Konventa e Vjenës mbi mbrojtjen e shtresës së ozonit dhe Konventa Kornizë e Ndryshimeve Klimatike
<i>Java e dhjetë:</i>	Legjislacioni mjedisore në Bashkimin Evropian
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	DG Mjedisit dhe Agjencia Evropiane e Mjedisit EEA
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Instrumentet legale dhe politikat mjedisore të BE-s, Legjislacioni horizontal dhe vertikal

<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Institucionet përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, ligjet dhe politikat
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Ligji për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, implementim dhe monitorimi i tij
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Ligji për mbrojtje e natyrës në Kosovë, implementim dhe monitorimi i tij. Vlerësimi intermedier

Punë seminarike

Në punën seminarike do të përfshihen tema të ndryshme që kanë të bëjnë me institucionet, marrëveshjet institucionet si dhe bazën ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Secili student do të zgjedhë temën specifike, për të cilën ai do të mbledhë informacion nga artikujt shkencorë, raste studimore ode dhe praktika të ndryshme. Studentët, rezultatet e mbledhura të do ti analizojnë dhe bazuar në rezultatet e fituara do të shkruajnë një raport të detajuar. Në fund secili student do të prezantojë punën e tij para studentëve të tjerë.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësime po ashtu janë obligative.

SYLLABUSI I lëndës Makrozoobentosi i ujërave të ëmbla

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN/Departamenti i biologjisë
Titulli i lëndës:	Makrozoobentosi i ujërave të ëmbla
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I/semsetri II
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.Prof.Ferdije Zhushi Etemi
Detajet kontaktuese:	044 249636 email:ferdije.zhushi@uni-pr.edu; ferdijezhushi2010@gmail.com
Përshkrimi i lëndës	<p>Kjo lëndë studion grupet shtazore nga radhët e invertebrorëve të cilët jetojnë në fundin e ekosistemeve të ujërave të ëmbla, në bentos. Këto grupe do të studiohen në aspektin e ciklit jetësor të tyre, ekologjisë, raporteve ushqyese dhe rolit që kanë në sistemin e monitorimit të ujërave si indikatorë për vlerësimin e cilësisë së tyre. Lënda do të përfshinë edhe tema mbi Direktivën kornizë Europiane për ujërat si dhe ndikimin e ndotjes antropogjene në ekosistemet ujore.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimet e këtij kursi janë që të pajisë studentët me njohuri të thelluara dhe shkathtësi mbi përbërjen e makrozoobentosit dhe shfrytëzimin e tij në monitorimin e cilësisë së ujërave të ëmbla. Studentët duke studiuar grupet kryesore të makroinvertebrorëve në terren dhe në klasë do njohin përbërësit kryesor të tyre, ciklin jetësor, habitatet, vlerat indikative si dhe përdorimin e tyre në biomonitorimin e ujërave dhe menaxhimin e tyre.</p> <p>Ndotja e ujërave nga burime të ndryshme, me theks të posaqëm ndotja antropogjene si dhe pasojat e saj në përbërjen e faunës së ekosistemeve ujore do të jenë një prej qëllimeve kryesore të lëndës.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të ketë këto njohuri, aftësi dhe shkathtësi:</p>

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikon përbërësit kryesorë të makrozoobentosit që shfrytëzohen për vlerësimin e ujërave të ëmbla 2. Kupton sistemin e biomonitorimit të ujërave 3. Përdorë metoda dhe teknika standarde për mbledhjen e mostrave të makrozoobentosit në teren 4. Klasifikon llojet e makroinvertebrorëve sipas ndjeshmërisë së tyre ndaj ndotësve 5. Analizon efektet e ndotjes antropogjene dhe stresin e shkaktuar në ekosistemet ujore 6. Llogaritë indexa të ndryshëm relevant për ta përcaktuar cilësisnë e ujit të një ekosistemi 7. Aplikon njohuritë dhe shkathhtësitë në praktikë
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	10	20
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	10	5
Ushtrime në teren	2	5	10
Kollokfiime,seminare			
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet,prezentimet ,etj	2	4	8
Totali			125

Metodologjia e mësimdhënies:

ligjërata (prezentime në PP), prezentime të studentëve; diskutime, ushtrime laboratorike dhe në teren

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi i studentëve nga pjesa teorike do të bëhet

	<p>me test kurse pjesa praktike do të vlerësohet me detyrën që i jipet studentit për të mbledhur makrozoobentosin në teren, identifikimin e grupeve në mostër dhe llogaritjen e indeksit për vlerësimin e cilësisë së ujit në lokalitetin e vendmostrimit. Kjo detyrë duhet të dorëzohet në formë të një punimi shkencor, hartimi i të cilit do të mësohet gjatë ligjëratave.</p> <p>Vlerësimi i pjesës teorike –test 50% Vlerësimi i pjesës praktike- dorëzimi i punimit i hartuar nga puna në terren-50% Total 100%</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1.Guliano Ziglio, Maurizio Siligardi and Giovanna Flaim (2006). Biological Monitoring of rivers-Applications and perspective, John Wiley & Sons, Ltd. 2. European Waterframework Directive ec.europa.eu/ Directive 2000/60/EC 3. Henri Tachet;avec la collaboration dePhilippe Richoux, Michael Bournaud et Philippe Usseglio-Polatera(2010): Invertebrates d'eau douce: systematique, biologie, ecologie,CNRS editions 2010
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1.W. Patric Mc Cafferty (2005): Aquatic Entomology: The Fisherman's and Ecologist's Illustrated Guide to Insects and Their Relatives 2. Punime shkencore nga autorë të ndryshëm

Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Historiku i shfrytëzimit të makrozoobentosit në monitorimin e cilësisë së ujërave
<i>Java e dytë:</i>	Grupet kryesore të makrozoobentosit
<i>Java e tretë:</i>	Sistemi i biomonitorimit të ujërave të ëmbla
<i>Java e katërt:</i>	Direktiva Europiane kornizë e ujërave
<i>Java e pestë:</i>	Vlerësimi biologjik i ujërave të ëmbla
<i>Java e gjashtë:</i>	Taxonomia e grupeve të makrozoobentosit-insektet
<i>Java e shtatë:</i>	Taxonomia e grupeve tjera të makrozoobentosit
<i>Java e tetë:</i>	Parametrat kimik, fizik dhe hidrologjik të ujërave të ëmbla

<i>Java e nëntë:</i>	Habitatet ujore dhe vlerësimi i tyre
<i>Java e dhjetë:</i>	Grupet ushqyese
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Ndotja antropogjene/stresi dhe efektet në ekosistemet ujore
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Metodat e mbledhjes së makrozoobentosit në teren
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Llogaritja e indeksave të ndryshëm për përcaktimin e cilësisë së ujërave të ëmbla
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Metodologjia e hartimit të një punimi shkencor që ka si subjekt hulumtimi përbërjen e makrozoobentosit
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Analiza e një punimi shkencor me makrozoobentos nga autorët vendor dhe një nga ata ndërkombëtar

Java	Puna praktike
<i>Java e parë:</i>	Grupet që i përbëjnë makroinvertebrorët- Studentët do të shohin një mostër të konservuar me grupet shtazore të makroinvertebrorëve
<i>Java e dytë:</i>	Metodat dhe teknikat e mbledhjes së makroinvertebrorëve në terren
<i>Java e tretë:</i>	Roli i vegjetacionit bregor në ekosistemet e lumenjëve Studentët në terren do të shohin shembuj me vegjetacion bregor dhe pa te dhe do të analizojnë ndikimet në botën e gjallë
<i>Java e katërt:</i>	Parametrat fiziko-kimik dhe hidromorfologjik të ekosistemeve ujore
<i>Java e pestë:</i>	Parametrat biologjik të cilësisë dhe vlerësimi biologjik I ekosistemeve akuatike=përparësitë e shfrytëzimit të makroinvertebrorëve në monitorimin e cilësisë së ujërave
<i>Java e gjashtë:</i>	Punë në terren -Mbledhja e mostrave të makroinvertebrorëve në terren me teknikën e multihabitatit.

<i>Java e shtatë:</i>	Seleksionimi dhe klasifikimi I mostrave në laborator
<i>Java e tetë:</i>	Karakteristikat kryesore të grupeve të makroinvertebrorëve bentik: Annelidet dhe Molluskat
<i>Java e nëntë:</i>	Karakteristikat kryesore të grupeve të makroinvertebrorëve -Gaforret (Crustacea)
<i>Java e dhjetë:</i>	Karakteristikat kryesore të grupeve të makroinvertebrorëve të klasës Insecta-rendet Plecoptera, Ephemeroptera, Trichoptera
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Rendet Diptera, Odonata, Megaloptera dhe Coleoptera
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Grupet funksionale ushqyese-klasifikimi sipas mënyrës së të ushyerit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Klasifikimi i makroinvertebrorëve sipas tolerancës ndaj ndotësve organik.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Indeksat e bazuar në makroinvertebrorët e ujërave të ëmbla,llogaritja e indeksave biotik BMWP, ASPT, BI dhe klasifikimi i cilësisë së ujërave në bazë të tyre
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Hartimi i një punimi shkencor duke shfrytëzuar makroinvertebrorët e mbledhur në terren

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime laboratorike dhe në terren është i obliguar. Studentët duhet të hyjnë me kohë në klasë dhe ti shkyqin telefonat celularë. Gjatë realizimit të punës në terren studentët janë të obliguar ta respektojnë kodin e veshjes dhe rregullat e sigurisë.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FSHMN-Drejtimi Ekologji mbrojtje e mjedisit		
Titulli i lëndës:	Mbrojtja dhe menaxhimi i tokës		
Niveli:	Msc		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	I		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:	5		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof Dr Kemajl Bislimi		
Detajet kontaktuese:	kemajl.bislimi@uni-pr.edu 044-243-470		
Përshkrimi i lëndës	Ky kurs fillon me një hyrje për vlerësimin e cilësisë së tokës. Sesionet e mëposhtme përfshijnë më shumë detaje mbi mirëmbajtjen dhe përmirësimin e aspekteve të ndryshme të cilësisë së tokës, rëndësinë e pjellorisë së tokës, strukturën dhe gjendjen fizike dhe aktivitetin biologjik. Do të shqyrtohen teknikat e menaxhimit për të parandaluar degradimin e tokës nga ndotja me substanca helmuese, salinizimi, erozioni i tokës dhe teknikat për të promovuar restaurimin e tokës së ndotur dhe të degraduar. Së fundmi, aspektet e menaxhimit të tokës do të përdoren për të nxjerrë në pah sa shumë prej mënyrave, aftësive dhe teorive të paraqitura që mund të aplikohen globalisht.		
Qëllimet e lëndës:	Lënda demonstroi karakterin ndërdisiplinor dhe ka për qëllim që të ofroj njohuritë për përbërjen dhe karakteristikat e tokës dhe rëndësinë e tokës në mjedis, duke prezantuar shkaqet kryesore të degradimit dhe të nspiroj studentët për të gjetur për parandalimin dhe korrigjimin e problemeve të dheut.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studenti do të jetë në gjendje të: - Të kuptojnë proceset e formimit të tokës, klasifikimin, ndotjen dhe shpërndarjen globale të ndotësve. -Vlerësojnë proceset e formimit të tokës, klasifikimin, ndotjen dhe shpërndarjen globale të ndotësve. -Analizojnë bashkëveprimet ndërmjet tokës dhe mjedisit dhe faktorët kryesorë që ndikojnë në uljen e cilësisë së tokës si dhe rritjen e potencialit të erozionit. - Identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë në uljen e cilësisë së tokës dhe rritjen e potencialit të erozionit. -Krijojnë praktikatat e menaxhimit të tokës për të zbutur ndikimet negative në tokë.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej

Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	3	1	3
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10	-	10
Ushtrime në terren	10	-	10
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	25
Përgaditja përfundimtare për provim	10/semester	-	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	-	4
Projektet,prezentimet ,etj	-	-	
Totali			126

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjerata tradicionale (kryesisht nga materiali i përgaditur më parë dhe i cili u është shpërndarë studentëve), mësim interaktiv me studentin në qendër, punë në grupe , seminare, debate, konsultime, pune praktike ne terren dhe laborator, tryezë e rumbullakët etj. Për ilustrim dhe përforcim të fakteve dhe koncepteve do të zgjedhë materiale pamore, si sllajde, figura, skema, filma-per rrezikimin e dheut ne permasa lokale dhe globale, burime nga interneti, si dhe studim dhe vrojtim ne terren-ekskursion . Do të përzgjedhen metoda e strategji të përshtashme të mësimdhënies e mesimnxënies që motivojnë dhe nxisin maksimalisht të nxënit aktiv te studentit.
Metodat e vlerësimit:	-Do të përdorë mjete dhe teknika të ndryshme te mesimdhënies bashkekohore për të mbledhur infomacione të mjaftueshme për vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së studentit. Do te behet vleresim i vazhdueshem i te gjitha aktiviteteteve te studentit, puna ne terren, puna ne laborator, shkathtesite manovruese me aparate dhe instrumente laboratorike etj. Arritjet e studentit do të vlerësohen duke u bazuar në kritere dhe duke aplikuar teste me shumë zgjidhje. Vlerësimi bëhet në pjesën praktike dhe teorike. Pjesa praktike e provimit është eliminuese Përqindja e pikave në vlerësim: Vlerësimi i parë 30 % Vlerësimi i dytë 30 % Vleresimi ne pjesen praktike 20 Angazhime të tjera 15% : puna seminarike, pjesëmarrja në debate, ekskurzion, angazhimi në zgjidhjen e detyrave lidhur me ndotjen e dheut të mjediseve të mbyllura dhe të hapura.

	Vijimi i rregullt 5% : vijimi me rregull në ligjërata, hyrja në sallë me kohë, mbajtja e qetësisë në mësim, etj. Pikët e fituara do të konvertohen në notë sipas sistemit ECTS.
Literatura	
Literatura bazë:	1.Meuser, Helmut Soil Remediation and Rehabilitation Treatment of Contaminated and Disturbed Land, 2013 2.Tan, K. H. (2000). Environmental Soil Science (2nd Edition). M. Dekker, New York. Monitoring & Remediation, ISBN 978-3-540-70777-6 3. Morgan, R. P. C. (2005). Soil Erosion and Conservation (3rd ed) Blackwell, Oxford.
Literatura shitesë:	Brady N.C. and Weil R.R. (2007). The nature and properties of soils (14th Edition). Wild, A. (2003). Soils, Land and Food: Managing the Land during the Twenty-First Century.
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohen
<i>Java e parë</i>	Syllabusi- Njohja me menaxhimin e mbrojtjes së tokës
<i>Java e dytë</i>	Vlerësimi i dheut, krijimi i hartave zonale të tokës
<i>Java e tretë</i>	Dheu, përdorimi i tokës dhe mjedisi
<i>Java e katërt</i>	Përbërësit e dheut
<i>Java e pestë</i>	Ndotja e dheut
<i>Java e gjashtë</i>	Ndikimi direkt i njeriut në degradimin e tokës
<i>Java e shtatë</i>	Vlerësimi i pare intermediar
<i>Java e tetë</i>	Kontaminimi i dheut dhe burimet e ndotjes së dheut
<i>Java e nëntë</i>	Mekanizmat e ndotjes dhe ndërveprimi tokë-ndotës
<i>Java e dhjetë</i>	Menaxhimi i kushteve fizike të dheut dhe ujit të tokës
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Monitorimi i ndotjes së dheut
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Kontaminimi i tokave dhe degradimi
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Menaxhimi jo i mire i hapësirave urbane
<i>Java e katërmëdhjetë</i>	Parandalimi dhe rehabilitimi i tokave të degraduara
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Vlerësimi i dytë intermediar

Ushtrimet nga pjesa praktike:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohen
<i>Java e parë</i>	Frymëmarrja e tokës: Majtja e sasisë së CO ₂ të liruar nga toka si indikator i aktivitetit biologjik
<i>Java e dytë</i>	Infiltrimi: Majtja e shpejtësisë së përthithjes së ujit nga toka
<i>Java e tretë</i>	Densiteti: Matja e peshës së tokës për njësi vëllimi.

<i>Java e katërt</i>	Përqeshmëria elektrike: Matja e përqeshmërisë elektrike në ujin e tokës.
<i>Java e pestë</i>	pH: Matja e përqendrimit të joneve aktive të hidrogjenit, për të vlerësuar aciditetin, bazicitetin ose neutralitetin e dheut
<i>Java e gjashtë</i>	Nitratet: Matja e nivelit të nitrateve në tokë.
<i>Java e shtatë</i>	Stabiliteti agreguar: Matja e nivelit të qëndrueshmërisë ndaj dezintegrimit të tokës pas futjes në ujë dhe shkundjes.
<i>Java e tetë</i>	Tretja: Matja e shpejtësisë së tretjes së partikulave të tokës në ujë.
<i>Java e nëntë</i>	Numërimi i kribave të tokës: Matja e numrit të kribave të tokës për njësi vëllimi dhe sipërfaqe.
<i>Java e dhjetë</i>	Rezistenca në penetrim: Matja e nivelit të rezistencës së tokës në depërtimin e një shkopi metalik në tokë.
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Matja e partikulave organike: Matja e partikulave organike më të vogla së 2 mm dhe më të mëdha se 0.053 mm (Cambardella and Elliot, 1992).
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Total i karbonit organik: Matja e sasisë të karbonit në materien organike në tokë.
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Enzimet e tokës: Matja e shpejtësisë së dekompozimit të materieve organike nga enzimet që gjenden në tokë.
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Struktura e tokës dhe e makroporeve: Matja e rërës, guralecëve dhe baltës si përbërësit kryesor të tokës.
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Matja e numrit të insekteve: Numri i insekteve apo kolonive të insekteve në sipërfaqe të tokës.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata, marrin pjesë në vizita studimore në terren. Shkyqja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësim poashtu janë obligative.	

SYLLABUS i Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike dhe Natyrore
Titulli i lëndës:	Metodologji e hulumtimit shkencor
Niveli:	Master (MSc.)
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Ekologji
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Fadil Millaku
Detajet kontaktuese:	fadil.millaku@un-pr.edu
Celulari:	044 39 4000
Përshkrimi i lëndës	
	Ky kurs përfshinë cikël të ligjëratave që kanë të bëjnë me: etikën dhe metodat e hulumtimit shkencor në shkencat e biologjisë dhe mjedisit; stilin e të shkruarit shkencor, paraqitjen e hipotezave, aplikimi i kriterëve që kërkohen nga revistat shkencore për publikime të punimeve shkencore. Ky modul përfshin rregullat e të shkruarit të punimeve shkencore burimore, analizimin e pjesëve të punimit shkencor, kategorizimin e punimeve shkencore, pjesët përbërëse të një punimi shkencor, rregullat e citimit të literaturës, përgatitjen e punimeve shkencore për botim si dhe përgatitja e prezantimeve në konferenca shkencore ndërkombëtare.
Qëllimet e lëndës:	Që studentet e nivelit master të marrin njohuri të mjaftueshme nga metodologjia e hulumtimit shkencor dhe pas përfundimit të këtij kursi të jenë në gjendje që në mënyrë të pavarur të mund të publikojnë rezultatet e tyre shkencore.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të vlerësojnë metodat e kërkimit shkencor në bioteknologji, ▪ Të analizojnë stilet e ndryshme të shkrimit shkencor, ▪ Të prezantojnë dhe diskutojnë hipotezat e kërkimit, ▪ Të shkruajnë dhe analizojnë pjesët e punimit shkencor, ▪ Të planifikojnë dhe ndërlidhin burimet e duhura të literaturës me temën e hulumtimit, ▪ Të bëjnë prezantime të rezultateve të ndryshme kërkimore në konferenca dhe takime të ndryshme shkencore ▪ Të përgatisin projekt propozime për temën e masterit ose për kërkime shkencore

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	12	12
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	4	2	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	12	12
Përgatitja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet ,etj	2	4	8
Totali	17	74	126
Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimi do të zhvillohet përmes ligjëratave, punës në grupe ku do këtë diskutime, analizë të punimeve, ideve dhe përkrahje të punës individuale dhe kreative.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fadil Millaku: Ligjërata të përgatitura nga lënda Metodologji e kërkimit shkencor ▪ Thomas, C. G. (2021): Research Methodology and Scientific Writing. Springer. 2nd Ed. ▪ Bardhyl Ceku & Forcim Kola (2008): Metoda të kërkimit shkencor, Tiranë. ▪ Petter Laake, Haakon Breien Benestad (2015): Research in Medical and Biological Sciences: From Planning and Preparation to Grant Application and Publication. Elsevier Science 		

Literatura shitesë:	<ul style="list-style-type: none"><li data-bbox="711 186 1383 262">▪ Aronson. S (1977): Style in scientific writing. Current Contents<li data-bbox="711 262 1383 361">▪ Dr. Ali Jakupi (2005): Metodologjia e punës shkencore Kërkimore, UP, Prishtinë.
----------------------------	--

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hulumtimi shkencor dhe llojet e shkrimeve shkencore
Java e dytë:	Stili i të shkruarit shkencor
Java e tretë:	Etika në hulumtimet shkencore
Java e katërt:	Metodat e hulumtimit shkencor në shkencat e biologjisë mjedisore
Java e pestë:	Struktura dhe zhvillimi i hipotezave. Variablat dhe dallimi midis tyre
Java e gjashtë:	Elementet e dizajnit të hulumtimit, Strategjitë kërkimore.
Java e shtatë:	Vlerësimi i parë intermediar, Hulumtim cilësor. Mbledhja e të dhënave parësore përmes intervistave, fokus grupeve etj.
Java e tetë:	Përzgjedhja e mostrave. Mostrimi i probabilitetit. Përcaktimi i madhësisë së mostrës.
Java e nëntë:	Analizë e punimeve shkencore
Java e dhjetë:	Rishikimi kritik dhe vlerësimi i literaturës. Dokumentimi i rishikimit të literaturës.
Java e njëmbëdhjetë:	Analiza sasiore dhe cilësore e të dhënave. Përgatitja e të dhënave për analiza.
Java e dymbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë intermediar, Korrigjimi i tekstit të shkruar
Java e trembëdhjetë:	Procedurat dhe përgatitja për botim e punimit shkencor
Java e katërbëdhjetë:	Pjesëmarrja, përgatitja dhe prezantimi i rezultateve shkencore në konferenca ndërkombëtare
Java e pesëmbëdhjetë:	Shkrimi dhe prezantimi i raportit të projektit
Plani i dizajnuar i ushtrimeve:	
Java	Ushtrimi që do të zhvillohet
Java e parë:	Metodat e sistemimit të punimeve shkencore
Java e dytë:	Përdorimi i formës pasive dhe aktive gjatë të shkruarit
Java e tretë:	Shembuj të etikës në hulumtime shkencore/plagjiatura
Java e katërt:	Metoda e vëzhgimit, analizës, sintezës, krahasuese dhe eksperimentale.
Java e pestë:	Shembuj të parashtrimit të hipotezave
Java e gjashtë:	Ushtrime si shkruhet: titulli, abstrakti, hyrja, materiali dhe metoda
Java e shtatë:	Vazhdim: shembuj si shkruhet Titulli, abstrakti, materiali dhe metoda.
Java e tetë:	Diskutim i rezultateve të hulumtimeve shkencore
Java e nëntë:	Analizë punimeve të publikuara
Java e dhjetë:	Shembuj të citimit të literaturës
Java e njëmbëdhjetë:	Përdorimi i simboleve për korrekturë
Java e dymbëdhjetë:	Korrigjimi i tekstit të shkruar
Java e trembëdhjetë:	Procedurat e publikimit të punimeve
Java e katërbëdhjetë:	Përgatitja dhe prezantimi i sllajdëve
Java e pesëmbëdhjetë:	Pjesët përbërëse të projektit

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar të jenë të rregullt në mësim, të hyjnë me kohë në sallën e mësimit, të

shkyçin telefonat celularë të mbajnë qetësi në mësim dhe të jenë aktiv gjatë diskutimeve.

Emertimi i kursit: Ndryshimet klimatike

Mesimdhësi: Prof. Linda Grapci-Kotori

Statuti i kursit: Zgjedhore

ECTS: 5

Përmbajtja e kursit: Ndryshimet klimatike janë ndër problemet më komplekse dhe sfiduese me të cilat jemi përballur si shoqëri, Ky kurs është disajnuar për t'u dhënë studentëve një kuptim themelor të bazës shkencore të ndryshimeve klimatike si dhe do t'i ekspozojë ata në aspekte të shumta të një fushe shumë ndërdisiplinore dhe gjithëpërfshirëse. Studentët do të njihen me natyrën fizike të sistemit tonë klimatik, me komponentët kontribues të sistemit dhe me mekanizmat bazë që rregullojnë mënyrën se si sistemi klimatik reagon ndaj nxitësve të ndryshimit. Më pas do të eksplorojmë ndryshimet klimatike nga perspektiva të shumta: ndryshimet paleoklimatike, ndryshueshmëria dhe ndryshimet e fundit historike, parashikimet e ardhshme klimatike si dhe çështjet sociale dhe ekonomike.

Qëllim i kursit; Qëllimi kryesor i kursit është që studentet të njihen me përcaktuesit kryesor të klimës: cilët faktorë ndikojnë në klimën, si e dimë këtë dhe sa të sigurt jemi? Te mbledhin dëshmi shkencore për klimën në periudhat e kaluara: Të përshkruajnë ndryshimin natyror të klimës në historinë e tokës. Ti analizojnë efektet e veprimtarisë antropogjene në klimën globale në 200 vitet e fundit. Të vlerësojnë çfarë dimë për ndryshimin e ardhshëm klimatik dhe si do të ndikojë në cilësinë e jetës së njerëzve?

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të kursit studentet do të jete në gjendje të;

- Shpjegojnë se si funksionon sistemi klimatik.
- Kuptojnë bazën fizike të ndryshimit të klimës.
- Përshkruajnë se si aktivitetet njerëzore po ndikojnë në emetimet e gazeve serrë.
